



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

ANTIVENDIM

PROJEKTVENDIM

datë \_\_\_\_\_ 2026

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2026

PËR

PËR

PROJEKTI AFATPËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT, AFATEVE DHE PROCEDURËS SË  
NJOFTIMIT PËR KËSHILLIN E KËSHILLIT PËR DHËNIEN ME QIRA TË ZONËS SË GJUETISË,  
MBARËSHITIMIT DHE RIPOPULLIMIT

Në mbështetje të nënit 100, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 27, të ligjit nr. 89/2025  
të Mjedisit, "Për gjuetinë", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

UNDOSH

VENDOSI:

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës janë miratuar zonat e gjuetie, mbarështimi ose ripopullimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e akteve për shpalljen e tyre, fillon procedurën për dhënie me qira të zonave përkatëse, duke zbatuar rregullat e konkurrimit publik.
2. Kryetari i bashkisë, ngre me urdhër një komision për ndjekjen e procedurave të konkurrimit publik (këtu e në vijim Komisioni).
3. Shpallja për dhënie në përdorim të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit, publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në faqen zyrtare të internetit të bashkisë, afishohet në ambientet e bashkisë dhe, kur është e mundur, në hyrje të zonës përkatëse, për një periudhë jo më pak se 30 ditë. Njoftimi përmban të paktën elementet e mëposhtme:
  - a) autoritetin qiradhënës;
  - b) vendin dhe datën e zhvillimit të konkurrimit, që nuk mund të jetë më më vonë se 15 ditë pune nga dita e fundit e afatit të publikimit të njoftimit;
  - c) llojin e procedurës të konkurrimit;
  - d) sipërfaqen në hektarë të zonës së gjuetisë, mbarështimit ose ripopullimit;
  - e) inventarin e faunës së egër në zonën përkatëse dhe kuotat e përafërta vjetore të gjuetisë;
  - f) vlerën fillestare të qirasë, të llogaritur në përputhje me parashikimet e nenit 28 të ligjit nr. 89/2025 "Për gjuetinë".
  - g) sistemin e pikëzimit të vlerësimit të ofertave;
  - h) afatin për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje, në përputhje me rregullat e konkurrimit publik, që përkon me ditë e fundit e afatit të publikimit të njoftimit.

- b) plani i biznesit dhe i përdorimit vjetor sipas shkronjave “d” dhe “dh” të pikës 6 të këtij vendimi – 30 pikë;
- c) kapacitetet teknike dhe profesionale sipas shkronjave “e” dhe “ë” të pikës 6 të këtij vendimi – 25 pikë;
- ç) oferta financiare – 25 pikë.

9. Komisioni, vlerëson me pikë çdo element të dokumentacionit të konkurrimit, duke renditur konkurruesit në bazë të pikëve të përfituara dhe harton raportin e vlerësimit që i paraqitet kryetarit të bashkisë, së bashku me listën e konkurrentëve të renditur sipas pikëve të fituara, jo më vonë se 3 ditë nga dita e zhvillimit të konkurrimit.

10. Brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i procesit të vlerësimit, kryetari i bashkisë, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë, vendos dhe shpall fitues subjektin që ka më shumë pikë.

11. Kur në konkurrim marrin pjesë më shumë se një konkurrues, njoftimi për shpalljen e fituesit vendoset në këndin e njoftimeve të bashkisë.

12. Subjektet konkurruese, brenda 7 ditëve kalendarike nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit të kryetarit të bashkisë, i cili, brenda 5 ditëve pune, i kthen përgjigje me shkrim subjektit.

13. Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, bashkia shpall publikisht fituesin dhe lidh kontratën e qirasë me afat 5-vjeçar me fituesin, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i gjithë procedurës së konkurrimit, por jo më vonë se fillimi i sezonit të gjuetisë.

14. Për rastin e dhënies në përdorim të zonës së gjuetisë, vlera e qirasë nuk mund të jetë më e ulët se vlera fillestare e përcaktuar në dokumentacionin e konkurrimit. Për sipërfaqet e zonave të mbarështimit dhe/ose ripopullimit, që merren në përdorim nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë, vlera e qirasë përfshihet në qiranë e caktuar për zonën e gjuetisë.

15. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**

**ED I R A M A**